



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljena/Protato Received/Delivety	03.08.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPCI	4512/2022		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.559/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.559/2022 të datës 22.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

me adresë banimi në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.559/2022 e datës 22.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohen Vendimet Nr.21/2022 i datës 03.06.2022, Nr.33/2022 i datës 10.06.2022, Nr.34/2022 i datës 10.06.2022 si dhe Nr.46/2022 i datës 10.06.2022 për refuzimin e aplikacioneve të ankuesit si dhe Vendimet Nr.21/1/2022 i datës 15.06.2022 dhe Nr.47/1/2022 i datës 21.06.2022, lidhur me refuzimin e ankesave të ankuesit, nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencinë së Kosovës për Informim dhe Privatësi.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi, që ti shqyrtoj aplikacionet e ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit për pozitat: “Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme” tek Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, “Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave” pranë Departamentit për qasje në dokumente publike si dhe “Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave” pranë Departamentit për mbrojtjen e të dhënave personale, pranë Agjencisë së Informimit dhe Privatësisë.

IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Agjencia e Kosovës për Informim dhe Privatësi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 06.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 21.05.2022 ka shpallur konkursin për lëvizje brenda kategorisë lidhur me pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim" pranë Divizionit për raportim dhe monitorim në Departamentin për qasje në dokumente publike, për klasën e pozitës Drejtues i ulët 1, si dhe fillimisht me datën 16.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkurset, ndërsa me datën 31.05.2022 ka shpallur konkurset për pozitat "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" tek Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për qasje në dokumente publike si dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në bazë të listës së aplikacioneve për pozitat e lartcekura të këtyre konkurseve ka aplikuar edhe ankuesi. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi, me datën 03.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.21/2022, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë, në konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim", pranë Divizionit për raportim dhe monitorim në Departamentin për qasje në dokumente publike, si dhe me datën 10.06.2022 ka Nxjerrë Vendimet Nr.33/2022, Nr.34/2022 si dhe Nr.46/2022, sipas të cilave i njëjti është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë për pozitat "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" tek Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për qasje në dokumente publike si dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kundër Vendimeve me numër Nr.21/2022 për mos përfshirjen në listën e ngushtë të datës 03.06.2022 si dhe Vendimeve Nr.33/2022, Nr.34/2022 si dhe Nr.46/2022, të datës 10.06.2022, për pozitat e lartcekura, ankuesi me datën 09.06.2022 dhe 15.06.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi. Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, me datën 15.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.21/1/2022, si dhe datën 21.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.47/1/2022, sipas të cilave vendime i ka refuzuar ankesat e ankuesit si të pabazuara lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë dhe ka lënë në fuqi Vendimet Nr.21/2022 të datës 03.06.2022 si dhe Nr.33/2022, Nr.34/2022 dhe Nr.46/2022 të datës 10.06.2022.

Ankuesi kundër vendimeve të lartcekura lidhur me refuzimin e ankesave të tij për mos përfshirjen në listën e ngushtë nga ana e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për pozitën e lartcekura, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net me datën 22.06.2022, ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 3640/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i është ndaluar pa të drejtë të konkurroj për të njëjtën kategori me arsye se i mungon përvoja profesionale, i njëjti po ashtu pretendon se përvojën e punës profesionale e ka vërtetuar nëpërmjet kontratave dhe vërtetimit të institucionit si dhe i ka dorëzuar diplomat, mirëpo që edhe pas këtyre dëshmime gjendja nuk ka ndryshuar lidhur me vendimin për të i'a lejuar konkurimin, ankuesi kërkon nga Këshilli ta shqyrtoj ankesën e tij dhe ti jepet e drejta për një konkurrencë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjeve në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:3640/2022 të datës 22.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 15.06.2022 e parashtruar tek Zyra e Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankuesit të datës 09.06.2022 e parashtruar tek Zyra e Burimeve Njerëzore; Diplomën e ankuesit me numër NR.1469 të datës 10.12.2010 ; Kopjen e noterizuar të diplomës së ankuesit të datës 07.07.2021; Diplomën e ankuesit me numër 1011-1830/1 të datës 18.06.2021; Vendimin me numër Ref.Nr:2/6-3432 të datës 19.07.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Vendimin me numër Ref.Nr:21/1/2022 të datës 15.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Vendimin me numër Ref.Nr:47/1/2022 të datës 21.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Vërtetimin Nr. Protokollit 85 të datës 06.04.2022 mbi marrëdhënien e punës së ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 22.06.2022 nga ankuesi për KPMSHCK-në; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.07.2022 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi me shkresat e bashkangjitura për lëndën e ankuesit; Aplikacionin e ankuesit me numër të referencës RN00008961 të datës 27.05.2022; Aplikacionin e ankuesit me numër të referencës RN00009045 të datës 31.05.2022; Aplikacionin e ankuesit me numër të referencës RN00009046 të datës 31.05.2022; Aplikacionin e ankuesit me numër të referencës RN00009050 të datës 31.05.2022; Konkursin e datës 21.05.2022 me numër të referencës RN00008961; Konkursin e datës 31.05.2022 me numër të referencës RN00009045; Konkursin e datës 31.05.2022 me numër të referencës RN00009046; Konkursin e datës 31.05.2022 me numër të referencës RN00009050; E-mailin zyrtar të datës 13.07.2022 lidhur me provat shtese për lëndën e ankuesit; Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.prot.109/2019 të datës 30.08.2019 në MAP; Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.prot.100 të datës 08.1.02.014 në MAP; Kontratën e punës së ankuesit me numër 2/2010 të datës 08.12.2010 në MAP; Vërtetimin Nr.Prot.87/2022 të datës 27.05.2022 mbi marrëdhënien e punës së ankuesit në MPB; Pasqyrën e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën nga data 01.08.2002-074.07.2018; Vendimin Nr.21/2022 të datës 03.06.2022 si dhe

Vendimet Nr.21/1/2022 të datës 15.06.2022, Nr.46/2022 të datës 10.06.2022, Nr.33/2022 të datës 10.06.2022, Nr.34/2022 të datës 10.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim", në Divizionin për raportim dhe monitorim pranë Departamentit për qasje në dokumente publike kanë qenë: *Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, në drejtësi, administratë publike, integritet evropian, teknologji informative, diplomaci dhe të ngjashme me to; Kualifikime të posaçme formale. Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.* Ndërsa kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim", kanë qenë:

Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon

Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

Të jetë vlerësuar të paktën 'mirë' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

Po ashtu ndërlidhur me pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm", "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në QDP-Departamenti për Qasje në Dokumente Publike dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në MDHP-Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se kriteret e konkursit kanë qenë: për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm -*Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike apo të ngjashme dhe Përvojën e punës-Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale,* për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për shqyrtimin e ankesave në QDP-Departamenti për Qasje në Dokumente Publike -*Diplomë universitare në fushën e drejtësisë apo administratë publike, gazetari, shkenca shoqërore me të paktën 240 kredi/ECTS dhe Përvojën e punës- Se paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale* si dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në MDHP-Departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale-*Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, në fushën e drejtësisë, administratës publik, integritet evropian, teknologji informative, diplomaci dhe të ngjashme dhe Përvojën e punës-Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesi, në pajtim me nenin 45 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesi me vendim është njoftuar që nuk ka

plotësuar kushtet e konkursit për pozitat e lartcekura me arsyetimin se nuk e posedon përvojën e punës profesionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitat e lartcekura në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, në bazë të dëshmisë së dosjes posedon Diplomën me Nr.1469 të datës 10.12.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik, me të cilën dëshmon se me datën 20.11.2008 ka përfunduar studimet themelore universitare në Departamentin e Shkencave Politike dhe Administratë-Drejtimi i Shkencave Politike dhe me këtë ka marrë kualifikimin "*Bachelor i shkencave politike me gjithsejtë 180 pikë-ECTS*", po ashtu në bazë të dosjes së ankuesit i njëjti posedon diplomën me numër 1011-1830/1 të datës 12.05.2021, e lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë- Fakulteti i shkencave shoqërore bashkëkohore me të cilën dëshmohet se ka përfunduar provimet e parapara të studimeve pasdiplomike në programin studimor - studime të diplomacisë dhe ka marrë titullin "*Magjistër i diplomacisë me gjithsejtë 120 kredi ECTS*".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se i njëjti i ka përmbushur kriteret e konkurseve të lart cekura për përvojën e punës, ka konstatuar se ankuesi studimet themelore universitare i ka përfunduar me datën 20.11.2008 prej ku ka marrë 180 pikë-ECTS, ndërsa studimet e nivelit master i ka përfunduar me datën 12.05.2021 kur edhe ka marrë diplomën me gjithsejtë 120 kredi-ECTS. Ndërlidhur me këtë fakt, Kolegji ka analizuar dëshminë mbi përvojën e punës së ankuesit dhe ka konstatuar se i njëjti posedon Vërtetimin me numër Nr.protokollit 85 të datës 06.04.2022 , e lëshuar nga ana e Menaxherit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilën dëshmon se ankuesi është në marrëdhënie pune pranë kësaj ministrie që nga data 14.05.2010 në Departamentin e Reformës së Administratës Publike në pozitën "*Koordinator për Ofrimin e Shërbimeve*", me të cilat mbulohen kontratat e dorëzuara nga ana e tij. Ndërlidhur me dëshminë mbi përvojën e punës së ankuesit ,Kolegji ka konstatuar se si përvoja e punës njihet vetëm përvoja e fituar pas diplomimit në fushën respektive, të përcaktuar në konkurs. Njohja e përvojës së punës vetëm pas diplomimit në fushën përkatëse është konfirmuar edhe me **Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**, andaj në këtë kuptim ankuesi pas përfundimit të studimeve universitare -diplomimit edhe pse ka fituar vetëm 180 kredi/ECTS dhe ka marrë titullin bachelor, i njëjti e ka fituar të drejtën e përvojës së punës me rastin e punësimit pas përfundimit të studimeve themelore dhe marrjes së titullit bachelor, ndërkaq me studimet e nivelit master me gjithsejtë 120 kredi/ECTS, i njëjti e ka fituar të drejtën e përmbushjes së kredive të nevojshme sipas konkurseve prej të paktën 240 kredi/ECTS deri në fazën e verifikimit paraprak, mirëpo jo edhe llogaritjen e përvojës së punës pas përfundimit të studimeve të shkallës së dytë- master. Andaj ndërlidhur me njohjen e përvojës së punës së ankuesit, Kolegji ka konstatuar se të njëjtit i llogaritet përvoja e punës që nga data 20.11.2008 pas përfundimit të studimeve themelore universitare dhe në këtë kuptim edhe e përmbush kriterin e përvojës së punës prej "*te paktën pesë (5) viteve përvojë të punës profesionale*", e kërkuar sipas kriterëve të konkurseve të lart përmendura dhe në këtë kuptim edhe pretendimi ankimor i tij lidhur me përmbushjen e kriterit të përvojës së punës është i bazuar, ligjor dhe i drejtë.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike, ka konstatuar se meqenëse ankuesi ka ofruar dëshmi që me rastin e aplikimit në bazë të dosjeve të bashkangjitura për pozitat "Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim", në Divizionin për Raportim dhe Monitorim pranë Departamentit për Qasje në Dokumente Publike, "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm", "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në QDP-Departamenti për Qasje në Dokumente publike dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në MDHP-Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, posedon përvojën e punës prej pesë (5) vitesh pas diplomimit si dhe ka ofruar dëshmi që i njëjti pas datës së përfundimit të nivelit të studimeve master ka fituar të drejtën për 240 kredi/ECTS siç është kërkuar me konkurse, atëherë sipas normave ligjore i njëjti edhe i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të këtyre konkurseve, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, me rastin e nxjerrjes së Vendimeve me numër Nr.33/2022 të datës 10.06.2022, Vendimi me numër Nr.34/2022 i datës 10.06.2022 si dhe Vendimi Nr.46/2022 i datës 10.06.2022 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankuesit ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 45 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj bazuar si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me numër Nr.21/1/2022 i datës 15.06.2022, si dhe Vendimi me numër Nr.47/1/2022 i datës 21.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi, janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 15 paragrafin 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vërtetimit të gjendjes faktike si dhe bazuar në Legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi, është e obliguar që ti shqyrtoj aplikacionet e ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit për pozitat: "Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme" tek Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm", "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për Qasje në Dokumente Publike si dhe "Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave" pranë Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pranë Agjencisë së Informimit dhe Privatësisë dhe në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të ndërmerr veprime ligjore duke u bazuar në nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 15 paragrafin 3 si dhe nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Informim dhe Privatësi, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të kujdeset për zbatimin e të njëjtit.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.559/2022, datë 03/08/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

